



## Përgjigjet ndaj Komenteve (KOSTT)

Shqyrtimi i tetë i tarifave të energjisë elektrike

**SHTE8 (2014-2015)**

**Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale**

### DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

**24 qershor 2014**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>Struktura e këtij dokumenti</b> .....	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>Komente e KOSTT në Raportin e ZRRE-se për MAR-in e OST/OT-se</b> .....	<b>2</b>
3.1	Komentet lidhur me Faktorin e Efikasitetit .....	2
3.2	Shërbimet ndihmëse .....	3
<b>4</b>	<b>Përmbledhje</b> .....	<b>3</b>

## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE8 (2014-2015)) që nënkupton llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të kompanive të rregulluara për vitin tarifor 2014-2015.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) ka dorëzuar aplikacionin e tyre për të Hyra Maksimale të Lejuara në shkurt 2014. Pas shqyrtimit të aplikacionit të tyre, ZRRE ka dërguar Raportin Vlerësues në të cilin ka paraqitur vërejtjet e ZRRE-së mbi aplikacionin e dorëzuar nga të licencuarit. Përgjigjet e KOSTT-it i janë dorëzuar ZRRE-së më 13 qershor 2014.

Ky Dokument paraqet përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS-it të pranuar lidhur me Raportin Vlerësues dhe ka për qëllim që të ju komunikoj palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me komentet e pranuar si dhe propozimet e ZRRE-së lidhur me të Hyrat Maksimale të Lejuara. Ky dokument ku janë të përfshira përgjigjet e ZRRE-se se bashku me Raportet vlerësuese finale të DTC-së do të shqyrtohen nga Bordi i ZRRE-së në seancën publike para vendimit final për aprovimin e MAR-it.

Vendimi i lëshuar nga ZRRE do të përcaktojë MAR-in për të Licencuarin KOSTT. Ngarkesat/tarifat të cilat do t'i aplikojnë këta të Licencuar duhet të jenë në përputhje me metodologjitë e përcaktimit të ngarkesave të miratuara nga ZRRE, përkatësisht me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve.

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me Raportin Vlerësues fillestar të ZRRE-së, Komentet e KEDS-it si dhe Raportin Vlerësues përfundimtar. Këto tri dokumente janë të publikuara në ueb-faqen e ZRRE-së.

## 2 Struktura e këtij dokumenti

KOSTT ka parashtruar komente të hollësishme lidhur me shqyrtimin dhe propozimet fillestare të ZRRE-së. Analizimi i hollësishëm nga ana e KOSTT është e mirëseardhur për të gjitha palët e interesit derisa na jap një siguri më të madhe në përpilimin e drejtë të raportit dhe përdorimin e drejtë të modeleve për llogaritjen e MAR-it, duke pasur parasysh që mund të bëhen lëshime apo gabime të paqëllimshme në kalkulime, përkatësisht në vlerësimin e të hyrave të lejuara për të licencuarit.

Me qëllim që ky Dokument të jetë sa më lehtë i kuptueshëm nga të gjitha palët, ZRRE e ka përgatitur në bazë të titujve të komenteve dhe qëndrimeve të paraqitura nga KOSTT.

**Duhet të theksohet se përdorimi i strukturës së këtij Dokumenti me strukturën e komenteve nga ana e KOSTT nuk do të thotë që ZRRE është pajtuar me komentet e dërguara nga i Licencuari.**

ZRRE ka dhënë përgjigje në të gjitha komentet e KOSTT-it dhe qëndrimet e ZRRE-së janë të paraqitura pas çdo komenti të KOSTT-it si më poshtë.

Te gjithë te interesuarit për komente te plota mund t'iu referohen komenteve të ofruara nga KOSTT-i te cilat jane te publikuara ne ueb faqen e ZRRE-së.

### **3 Komente e KOSTT në Raportin e ZRRE-se për MAR-in e OST/OT-se**

#### **3.1 Komentet lidhur me Faktorin e Efikasitetit**

KOSTT ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me Faktorin e Efikasitetit, ku ZRRE në procesin e SHTE7 e ka vendosur në nivelin prej 4%, nivel të cilin ka vazhduar ta aplikoj edhe në procesin e SHTE8 (2014-2015).

Sipas KOSTT-it, niveli i tillë është i lartë dhe i paarrtshëm, duke e arsyetuar atë se parametrat kryesorë matës siç janë: humbjet në transmission, siguria në furnizim, operimi i sistemit, e kanë një kufi që fizikisht nuk mund të arrihet më shumë! Në këtë aspekt, KOSTT deklaron që “është një nga kompanitë më eficiente në rajon dhe më gjerë”. Ndërsa parametrat financiar të cilat sipas KOSTT e mbështesin këtë nivel, janë: paga mesatare më e ulëta në rajon, tarifa mesatare më e ulëta ne rajon, shpenzimet e mirëmbajtjes më të ulëta në rajon, etj.

Sipas KOSTT, faktori i efikasitetit për një kompani si KOSTT-i e cila operon në Kosovë duhet të jetë edhe nën nivelin e mesatares në shtetet e Evropës (2.9%)

KOSTT ka shprehur shqetësimin edhe të aplikimit të Faktorit të Efikasitetit në të gjitha kategoritë e Shpenzimeve Operative, me arsyen se me rritjen e efikasitetit dhe zhvillimin e kompanisë, rriten edhe disa kategori të shpenzimeve operative siç janë shpenzimet e pagave.

ZRRE e kupton shqetësimi e KOSTT lidhur me Faktorin e Efikasitetit, ku ZRRE gjate procesit te shqyrtimit periodik ka vendosur këtë faktor në nivel prej 4%. ZRRE ka pranuar një kërkesë për zvogëlimin e këtij faktori si me Aplikacionin tarifor e po ashtu edhe përmes komenteve te dërguara nga KOSTT lidhur me Raportin Vlerësues te ZRRE-se për MAR. Ne i kemi analizuar me kujdes këtë kërkesë të KOSTT dhe nuk kemi pas justifikime te mjaftueshme se duhet te ndryshohen vendimet e ZRRE-se të marra gjate procesit te Shqyrtimit periodik të të Hyrave të Lejuara Maksimale për periudhën pesë vjeçare.

KOSTT pretendon se nuk mundet te arrihet një nivel i tillë i efiqences duke potencuar se parametrat kryesor matës, siç janë humbjet dhe disa parametra tjerë, janë ne kufijtë e pranueshëm dhe nuk mund te arrihet me tepër. Duhet te theksohet se faktori efikasitetit nuk ka asgjë të beje me nivelin e humbjeve ne sistemin e Transmisionit dhe nuk duhet te ndërlidhet Faktori i Efikasitetit me nivelin e humbjeve në Transmission. Duhet te theksohet se Faktori i Efikasitetit siç edhe mund te shihet nga Rregulla për Vendosjen e Çmimeve ka te bej direkt vetëm me Shpenzimet operative.

Po ashtu KOSTT ka shpreh shqetësimin e tij lidhur me aplikimin e Faktorit te Efikasitetit për të gjitha kategoritë e Shpenzimeve operative , duke pretenduar se ky faktor nuk do duhej te aplikohet te disa

kategori shpenzimeve me theks të veçantë tek shpenzimet e personelit, për të cilën gjë ZRRE e rithekson se një gjë e tillë nuk mund të përjashtohet duke pasqyruar Rregullën.

### **3.2 Shërbimet ndihmëse**

KOSTT në lidhje me shërbimet ndihmëse të kërkuara në vlerë prej €1.6 milion, ka sqaruar që ato përfshijnë vetëm Shpenzimet e Rregullimit Sekondar dhe nuk përfshijnë supozimet për Shpenzimet e Rregullimit terciar. Përkundër kësaj, Shpenzimet e Rregullimit Terciar do të fillojnë të realizohen në momentin e nënshkrimit të kontratës me EMS (Serbi). Prandaj KOSTT kërkon nga ZRRE që të zotohet se Kostot e Rregullimit Terciar do të rimbursohen (agjustohen), nëse KOSTT mandatohet që do të ekzekutojë kontratën e shërbimeve ndihmëse për vitin 2014.

Siç e kemi cekur në Raportin vlerësues për MAR-in e KOSTT-it, ZRRE ka mbajtur disa takime me KOSTT-in lidhur me këtë çështje dhe e ka përkrahur nënshkrimin e marrëveshjes në mes të KOSTT-it dhe EMS-it lidhur me shërbimet sekondare dhe terciare. Në këtë fazë duke pasqyruar se ende nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për aprovimin e këtyre kostove, ZRRE-ja e ka të pamundur që të përfshihen në kalkulimet finale të MAR-it të KOSTT.

Pra, në mungesë të informatave për kostot e sakta të këtyre shërbimeve dhe të hyrave që lidhen me transitin të cilat KOSTT-i pret t'i inkasojë pas nënshkrimit të marrëveshjes, ZRRE-ja, në këtë fazë, nuk do t'i lejojë kostot nga Shërbimet Ndihmëse (Ancillary Services) për Vitin e dytë Relevant.

Në dëshirë të sigurojmë KOSTT-in se nëse këto kosto do të realizohen do të përfshihen në MAR-in e KOSTT-it gjatë vitit të ardhshëm relevant s'bashku me kostot e interesit siç është e cekur në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve.

## **4 Përmbledhje**

Nga propozimet e paraqitura në Raportin Konsultativ, ZRRE parasheh që shpenzimet operative që do të përfshihen në MAR-in e vitin 2014 janë €7.1 milionë, ndërsa parashikimet e KOSTT për realizimin e këtyre shpenzimeve për vitin 2014 janë €8.7 milionë, ashtu siç është paraqitur edhe kërkesa për këto shpenzime në aplikacionin për SHTE 8.

Sipas KOSTT, "mungesa prej €1.6 milionë, që pritet të paraqitet në fund të vitit, do të krijojë vështirësi për kompaninë. I vetmi burim që KOSTT mund ta shfrytëzojë për këtë mungesë mund të konsiderohet fitimi që i paraqitet kompanisë nga kursimet e viteve të mëparshme".

ZRRE rithekson se të Hyrat e Lejuara Maksimale të cilat janë prezantuar në Raportin vlerësues për MAR-in e KOSTT-it janë të mjaftueshme për operim të sukseseshëm të KOSTT-it.